



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS**  
**OSNOVNI SUD GJAKOVA - BASIC COURT OF GJAKOVA**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**AGJ.I.nr. 51/2022**  
**Datë 04.03.2022**

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykatat (nr. 06/L-054), Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 11 par. 1, 3, 7 dhe 12, si dhe nenit 17 par. 1, 3, 4, 5, 6 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave, si dhe planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët në Rahovec dhe Malishevë, kryetari i Gjykatës Nikollë Komani, pas marrjes së propozimit të kolegjiut të kësaj Gjykate, me datën 04.03.2022 përcakton:

**PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËVE TË GJYQTARËVE  
DHE ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE NË GJAKOVË DHE DY DEGËVE  
NË RAHOVEC DHE MALISHEVË**

**Neni 1**

Kryetari i Gjykatës, bazuar në kompetencat ligjore që ka për organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës, si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur pas hartimit të planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët e saja, e kjo si rezultat i avancimit të gjyqtarëve Malsor Kryeziu dhe Besnik Bislimaj në Gjykatën e Apelit, si dhe pas dorëheqjes së gjyqtarit Ilir Rashkaj, nga pozita e gjyqtarit mbikëqyrës në Degën në Rahovec, është paraqitur si domosdoshmëri riorganizimi i punës së Gjykatës me dy degët e saj. Andaj bazuar në kompetencat ligjore ka thirrur kolegjiutin e Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët e saj, për plotësimin dhe ndryshimin e këtyre raporteve të punës.

**Neni 2**

- 2.1. Në Gjykatën Themelore në Gjakovë, pas avancimit të gjyqtarëve Malsor Kryeziu dhe Besnik Bislimaj në Gjykatën e Apelit, si udhëheqës i divizionit civil caktohet gjyqtarja Afijete Sada-Gllogjani.
- 2.2. Lëndët civile me të cilat kanë qenë të ngarkuar dy gjyqtarët të cilët janë avancuar, do të ju ndahen gjyqtarëve Durim Bala dhe Mirjeta Shala, dhe atë me lëndët e gjyqtarit Malsor Kryeziu do të ngarkohet gjyqtari Durim Balaj, ndërsa me lëndët e gjyqtarit Besnik Bislimaj do të ngarkohet gjyqtarja Mirjeta Shala.

**Neni 3**

- 3.1 Pasi që gjyqtari mbikëqyrës i Gjykatës-Dega në Rahovec ka dhënë dorëheqje dhe e njëjta është aprovuar nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në mbledhjen e datës 24.02.2022, gjyqtari Ilir Rashkaj, caktohet që të punoj si gjyqtar në Departamentin për Krime të Rënda në Gjakovë.

3.2 Pas caktimit të gjyqtarit Ilir Rashkaj në Departamentin e Krimeve të Rënda, atëherë ky Departament do të plotësohet ashtu që i njëjti do të udhëheq me trupin e III-të gjykues, si dhe do të kryesoi kolegjin e III-të shqyrtues.

3.2 Meqenëse gjyqtari Shaqir Zika, do të pensionohet gjatë muajit nëntor të këtij viti, i njëjti nuk do të ngarkohet me lëndë të reja, do të vazhdoj ti mbaj lëndët me të cilat është i ngarkuar, por do ti trajtojë edhe lëndët e procedurës paraprake që bien në kompetencë të këtij departamenti, vetëm në rast të pengesave ligjore apo ndonjë pengës tjetër këto lëndë do të ju ndahen në punë gjyqtarëve tjerë me program të SMIL-it.

#### **Neni 4**

Meqenëse gjyqtarit mbikëqyrës në Degën në Rahovec Ilir Rashkaj, është caktuar gjyqtar në Departamentin për Krime të Rënda, atëherë me vendim të kryetarit të Gjykatës, ushtruesi i detyrës është caktuar gjyqtari Shaqir Zika, i cili do të udhëheq me Gjykatën Themelore-Dega në Rahovec, si gjyqtarë mbikëqyrës deri në zgjedhjen e gjyqtarit mbikëqyrës sipas procedurave të konkursit.

#### **Neni 5**

5.1. Gjyqtari Dardan Hoxha, caktohet që të punoi në Divizionin Penal dhe i njëjti do të ngarkohet me lëndë penale dhe të kundërvajtjes.

5.2. Gjyqtari Dardan Hoxha, do të ngarkohet me lëndët e natyrës penale dhe të kundërvajtjes me të cilat ka qeni i ngarkuar gjyqtari Ilir Rashkaj, si dhe do ti mbaj në punë edhe lëndët civile me të cilat është i ngarkuar.

5.3. Gjyqtarët Mizair Shabani dhe Dardan Hoxha, të cilët i trajtojnë lëndë penale dhe me lëndë kundërvajtëse të cilat lëndë do të ju ndahen sipas programit të SMIL-it.

#### **Neni 6**

Ky plotësim ndryshim i planit vjetor të punës, është pjesë përbërëse e planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe dy degëve në Rahovec dhe Malishevë AGJ.I nr. 278/2021 të datës 30.12.2021, i cili plan në pjesën që nuk është ndryshuar mbetet në fuqi.

#### **Neni 7**

Me këtë ndryshim të planit të punës njoftohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

